REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI I BASHKISË

Nr. 861 Prot Maliq, më 19.02.2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. 2 datë 19.02.2025

"Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga të ardhurat e veta"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma (dh) , Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.138, datë 26.12.2024 "Miratimi i buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024" , Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.68,datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" , Udhëzimit të Ministrisë të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025" i propozoj Këshillit të Bashkisë :

1. Të miratojë përdorimin e fondit prej **1,200 mijë lekë** të parashikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2025 nga të ardhurat e veta për "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme ndërtimore në mbrojtjen e jetës dhe në pronësi të njerëzve" me objekt **"Riparim Ura".**
2. Të bëhet ndryshimi në buxheti si më poshtë:

Pakësim *në 000/lekë*

Gr.	Kap.	Kod. Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti		
00	05	03280	606	9999999	"Mbrojtja Civile"	**1,200**

Shtesë

Gr.	Kap.	Kod.Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti		
00	05	04520	602	9999999	"Riparim ura"	**1,200**

3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Sektori i Emergjencave Civile në bashki.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

RELACION

"Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga të ardhurat e veta"

Fondi i Emergjencave Civile i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Maliq ,në shumën **4,000 mijë lekë**, parashikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2025 nga të ardhurat e veta ju propozohet të përdoret për "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme ndërtimore në mbrojtjen e jetës dhe në pronësi të njerëzve" me objekt:

1. **"Riparim ura"**

Në zonën e Moglicës kemi disa ura të cilat duhet rehabilituar .

Në këto ura lëvizin banorët edhe nxënësit , janë me konstruksion metalik e beton dhe kanë nevojë për zëvendësimin e pjesës së drurit .

Situata është emergjente ndaj edhe menduam t'ja u sjellim këtë propozim .

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ